

V E N D I M
Nr.13, datë 22.11.1993

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

Rustem Gjata,	Kryetar, i Gjykatës Kushtetuese
Feti Gjilani,	Zv/Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Manol Konomi,	Anëtar i ""
Veli Budo,	Anëtar i ""
Franc Jakova,	Anëtar i ""
Thimjo Kondi,	Anëtar i ""
Natasha Sheshi,	Anëtar i ""
Ylvi Myrtja,	Anëtar i ""
Hilmi Dakli,	Anëtar i ""

Me sekretare Drita Filto më datën 22.11.1993, shqyrtoi në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.14, që i përket:

KËRKUES: 1. SHOQATA KOMBËTARE E TË SHPRONËSUARVE
"PRONËSI ME DREJTËSI"

2. SHOQATA KOMBËTARE E TË PERNDJEKURVE POLITIKË EKONOMIKE (ISH-KULAKË)

OBJEKTI

Deklarimin si veprim antikushtetues të mosmarrjes në shqyrtim nga Kuvendi Popullor të dy projektligjeve të propozuara nga 20.000 veta me të drejtë vote.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjo i relacionin përkatës,

V Ë R E N:

Shoqata "Pronësi me Drejtësi" dhe Shoqata e të Përndjekurve Politico-Ekonomikë, me kërkesën e përbashkët të paraqitur më datën 5.6.1993, i kanë paraqitur Kryesisës së Kuvendit Popullor kërkesën datë 31.3.1993 me të cilën kanë kërkuar kthimin për ridiskutim në Kuvend të Ligjit "Për Tokën" nr.7501, 19.7.1991 dhe amendamentit të tij, miratuar me dekretin nr.525, datë 24.6.1993, si dhe ligjin "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve". Së bashku me kërkesën kanë paraqitur edhe listat me 22.000 firma të shtetasve me të drejtë vote, dy projektligje me relacionin përkatës me të cilin shpjegojnë dhe argumentojnë përmbajtjen e tyre. Këto veprime i kanë kryer në mbështetje të nenit 23 të ligjit "Për dispozitat kryesore kushtetuese", që njeh iniciativën ligjvënëse edhe të një grupi shtetasish prej 20.000 vetash me të drejtë vote. Po në kërkesën e tyre pretendohet se Kryesia e Kuvendit Popullor me shkresën nr.2041, datë 10.4.1993 nuk ka marrë parasysh sa më sipër. Për këtë arsye i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shkeljen e së drejtës që i njeh neni 23 i ligjit të përmendur.

Bashkë me kërkesën kanë bashkëngjitur edhe këto dokumente: Përgjigjen e dhënë për kërkesën dhe njoftimin se listat me 22.000 firmat ndodhen të depozituara pranë Kuvendit Popullor.

Gjykata shqyrtoi dokumentat e paraqitura dhe duke qenë se, sipas nenit 23 të ligjit "Për dispozitat kryesore kushtetuese", iniciativa ligjvënëse, i njihet edhe 20.000 shtetasve me të drejtë vote, i kërkoi Kryesisë së Kuvendit Popullor me shkresën datë 7.7.1993 të konfirmonte nëse shoqatat e përmendura e kanë paraqitur projektligjin sipas kërkesave të ligjit kushtetues si edhe nëse i është dhënë përgjigje tjetër përveç asaj të datës 10.4.1993, që është paraqitur prej tyre. Kryesia e Kuvendit Popullor në përgjigje pranon se Shoqata e të Shpronësuarve "Pronësi me Drejtësi", ka paraqitur dy variantet e saj të projektligjeve për kthimin dhe kompensimin e pronave të grabitura nga diktatura komuniste bashkë me nënshkrimet e shtetasve në pajtim me kërkesat e ligjit kushtetues duke shtuar se materialet i kanë kaluar komisionit të ligjeve dhe grupeve parlamentare për shqyrtim.

Kuvendi Popullor më datën 11.11.1993 në Seancë Plenare i shqyrtoi të dy projektet e paraqitura dhe pas diskutimit e votimit si përfundim nuk u miratuan.

Në këto rrethana kërkesa e shoqatave ankuese për shkelje të nenit 23 të ligjit "Për dispozitat

kryesore kushtetuese", nuk ka më mbështetje.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 25 e 26 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese",

V E N D O S I:

Rrëzimin e Kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe i formës së prerë.

Tiranë më 22.11.1993